

[shqiptarja.com]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Kryetari

Tiranë, më 22.07.2019

Në vëmendje të:

Z. GIANNI BUQUICCHIO

PRESIDENTI I KOMISIONIT TË VENECIAS

Lënda: Kërkesë për një opinion urgjent

I nderuar Z. BUQUICCHIO,

Më lejoni të përfitoj nga ky rast për të ripërsëritur mirënjohjen e Kuvendit të Shqipërisë, për kontributin e madh që Komisioni i Venecias ka dhënë në lidhje me konsolidimin e sundimit të ligjit dhe institucioneve kushtetuese në Shqipëri. Opinionet e dhëna nga Komisioni i Venecias konsiderohen si një garanci themelore për qëndrueshmërinë e legjislacionit dhe praktikave institucionale në Shqipëri. Reputacioni i Komisionit të Venecias është i padiskutueshëm dhe kontributi i tij vazhdon të vlerësohet shumë nga populli Shqiptar dhe nga institucionet shtetërore.

Në emër të Kuvendit të Shqipërisë, po ju dërgoj këtë kërkesë për dhënie të një mendimi mbi një situatë të ndjeshme dhe shumë të rëndësishme për mirëfunksionimin e demokracisë në Shqipëri.

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në ushtrim të kompetencave të dhëna nga Kushtetuta (neni 92/gj) ka nxjerrë dekretin nr. 10928, datë 05.11.2018 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore". Në bazë të këtij dekreti, është caktuar si datë e mbajtjes së zgjedhjeve, data 30 qershor 2019. Presidenti në nxjerrjen e këtij dekreti ka mbajtur në vëmendje

se mandati katërvjeçar i organeve të qeverisjes vendore përfundonte në datën 10 Gusht 2019 dhe ka respektuar urdhërimet ligjore për caktimin e datës së zgjedhjeve parashikuar nga neni 8, 9 dhe 10 i Kodit Zgjedhor.

2. Në zbatim të Dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës, filluan të gjitha procedurat sipas Kodit Zgjedhor për bërjen të mundur të realizimit të procesit zgjedhor në datën 30 Qershor 2019. Konkretisht :

- U ngritën Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (Neni 28 i K.Zgjedhor);
- U përgatitën dhe u shpallën listat e zgjedhësve (Neni 56 i K.Zgjedhor);
- Përfundoi procesi i regjistrimit të partive politike (Neni 64 i K.Zgjedhor);
- U depozituan listat e kandidatëve të partive politike (Neni 67 i K.Zgjedhor);
- Filloi fushata zgjedhore (Neni 77 i K.Zgjedhor), etj

3. Për zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019 u regjistruan rreth 48 subjekte zgjedhore. Partia Demokratike (PD) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), vendosën të mos regjistrohen si subjekte zgjedhore në këto zgjedhje. Më parë, në Shkurt 2019, disa ish deputetë të këtyre partive të përfaqësuara në Kuvendin e Shqipërisë, dhanë dorëheqjen nga mandati i deputetit, pas një bojkoti të gjatë të jetës parlamentare dhe të mbështetur nga elektorati i tyre organizuan protesta për dorëheqjen e qeverisë. Më shumë se gjysma e vendeve vakant të krijuara në Kuvend, për shkak të këtyre dorëheqjeve, u plotësuan me deputetët e rinj të opozitës nga listat shumëëmërore të PD dhe LSI, sipas procedurave ligjore, të ndjekura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe vetë Kuvendi. Në këtë mënyrë, Kuvendi arriti të ruajë funksionalitetin e tij për çdo lloj vendimmarrje kushtetuese.

4. Ndërkohë që kishte filluar periudha zgjedhore, Presidenti i Republikës nxorri dekretin nr. 11199, datë 10.06.2019 "Për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore"". Sipas nenit 1 të këtij dekreti, shfuqizohet dekreti nr. 10928/2018, duke vendosur, në këtë mënyrë, anulimin e datës 30 qershor 2019, si datë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Arsytet e dhëna nga Presidenti i Republikës, mbi anulimin e datës së zgjedhjeve, kanë të bëjnë me:

- Shqetësimin e thellë mbi situatën politike në vend;
- Nevojën për ç'tensionimin e situatës në vend;
- Vetëdijen se kushtet aktuale nuk do të siguronin zgjedhje të vërteta, demokratike, përfaqësuese dhe gjithëpërfshirëse;
- Bindjen se kjo vendimmarrje, në kushtet aktuale, është mënyra e vetme për të ndihmuar në zgjidhjen e krizës së rëndë ku ndodhet vendi;
- Argumentin se kjo vendimmarrje mbështetet në kompetencën që i jep neni 92, shkronja "gj" e Kushtetutës, si dhe preambula e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 3 e nenit 1, neni 3, pika 2 e nenit 4, neni 15, neni 45, pika 1 e nenit 86, pika 3 e nenit 88 dhe neni 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organi përgjegjës për organizimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, nuk e vlerësoi si të detyrueshëm për zbatim dekretin e Presidentit

për anulimin e datës së zgjedhjeve vendore, por vijoi me administrimin e procesit zgjedhor, duke arsyetuar në vendimin e tij se ky akt i Presidentit është absolutisht i pavlefshëm, për arsye se ka dalë në kapërcim të kompetencave që Kushtetuta i jep Presidentit. Sipas KQZ, ndryshimi i datës së zgjedhjeve administrative nuk është një prerogativë e Presidentit e parashikuar në Kushtetutë apo Kod Zgjedhor. Sipas nenit 94 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre të njohura shprehimisht në Kushtetutë dhe ligj. Akti që nxirret në mungesë të kompetencës dhe, për më tepër, në kundërshtim të hapur dhe flagrant me Kushtetutën dhe ligjin, është nul dhe konsiderohet që nuk ka ekzistuar asnjëherë.

6. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin datë 13 Qershor 2019 miratoi Rezolutën mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 "*Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore*". Me këtë Rezolutë, Kuvendi i Shqipërisë:

- bazuar në përgjegjësinë që i ngarkon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 1 të saj, ku shprehimisht thuhet se Shqipëria është Republikë Parlamentare ;
- në respektim të parashikimit kushtetues se qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike ;
- duke mbajtur parasysh rolin dhe kompetencat e Presidentit të Republikës në republikën parlamentare dhe,
- në zbatim të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10928, datë 05.11.2018 *për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore më datë 30 qershor 2019*, akt ky që përbën të vetmin akt të ligjshëm të nxjerrë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019 dhe me efekte juridike të krijuara,

ka mbështetur qëndrimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për vijimin e procesit zgjedhor dhe ka inkurajuar këtë organ të vijojë të mbrojë pacënueshmërinë, si dhe të garantojë vazhdimësinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 30 Qershor 2019. Gjithashtu me këtë Rezolutë, Kuvendi i Shqipërisë i bëri thirrje të gjitha organeve publike që ngarkohen nga ligji me detyra në kuadër të mbarëvajtjes dhe organizimit të zgjedhjeve vendore të Qershorit 2019, të konsiderojnë si inekzistent aktin e Presidentit datë 10.06.2019 për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 dhe të vijojnë përmbushjen e detyrave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës, për të garantuar të drejtën kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor.

7. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 13.06.2019 ka shqyrtuar një çështje të ngritur nga subjekti zgjedhor "Partia e Unitetit Kombëtar" (PUK), që kërkonte çregjistrimin nga procesi zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, duke pretenduar se me dekretin e Presidentit nr. 11199, datë 10.06.2019 janë anuluar zgjedhjet vendore dhe me Vendimin nr.836, datë 13.06.2019 ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndër të tjera, ka arsyetuar se dekreti i Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të nenit 108, paragrafi 2, germa "a" të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) dhe se në kuptim të nenit 110 të KPA, "*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*" Çdo subjekt publik a privat që ndesh një akt të tillë nuk i nënshtrohet rregullave të tij dhe nuk e merr parasysh gjatë veprimtarisë së tij.

8. Në vendimin e vet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, arsyeton edhe se "... i vetëdijshëm se nuk është ai organi publik që mund të shfuqizojë një akt administrativ të një organi tjetër publik, në pozitën e "organit që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative" (ankimin administrativ) sipas pikës 2 të nenit 110 të KPA, "ka detyrimin ligjor të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ" Dekretit nr.11199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës (sipas detyrimit që parashikon neni 111 i KPA), e konsideron këtë dekret sikur nuk ekziston. Në mbështetje të parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke qenë organi më i lartë shtetëror i përhershëm i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë, duke u njohur edhe me aktin në fjalë, e konstaton atë si absolutisht të pavlefshëm, nul, sikur nuk ekziston dhe vijon punën për realizimin me sukses të procesit zgjedhor për zgjedhjet e organeve të pushtetit vendor të datës 30.06.2019".

9. Ky vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u bë objekt shqyrtimi nga Kolegji Zgjedhor që përbën të vetmen gjykatë për çështjet e zgjedhjeve në Shqipëri, vendimet e së cilës janë përfundimtare dhe të formës së prerë. Mbi bazën e padisë së PUK, Kolegji Zgjedhor me vendimin e tij nr. 12, datë 24.06.2019 arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 836, datë 13.06.2019 është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve si dhe në zbatim të drejtë të ligjit, dhe për pasojë vendosi "Rrëzimin e padisë së palës paditëse Partia e Unitetit Kombëtar. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim".

10. Sipas arsytimit të Kolegjit Zgjedhor, ky i fundit e mori në shqyrtim si gjykata kompetente këtë çështje bazuar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese shqiptare, e cila me Vendimin e saj nr. 150, të datës 16 qershor 2017, arsyeton se: "Për sa i takon legjitimitetit racione materia, Kolegji vlerëson se Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 131 dhe 134 të Kushtetutës, merr në shqyrtim në shkallë të fundit kërkesat që drejtohen kundër akteve të pushtetit publik që cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se akti ndaj të cilit është ushtruar ankim, dekreti i Presidentit të Republikës, është një akt administrativ individual, pasi ka për objekt vetëm caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë. Për këtë arsye, Kolegji çmon se ky akt nuk hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate por në juridiksionin e gjykatave administrative dhe për këtë arsye, kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate me objektin sipas kërkesës. Përputhja apo jo e dekretit të Presidentit të Republikës me dispozitat e Kodit Zgjedhor nuk është në juridiksionin e kësaj Gjykate, por në juridiksionin e gjykatave administrative apo, sipas rastit, të Kolegjit Zgjedhor dhe si e tillë nuk mund të shqyrtohet nga kjo Gjykatë".

11. Kolegji Zgjedhor në vendimin e tij nr. 12, datë 24.06.2019 arsyetoi ndër të tjera se: "...Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019 është një akt absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108, paragrafi 2, germa "a" të Kodit të Procedurave Administrative (KPA), sipas të cilit: "Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik". Sipas Kolegjit, "...kompetencat e Presidentit të Republikës ushtrohen nga pikëpamja formale me anë të dekretit siç parashikon neni 93 i Kushtetutës. Ky përcaktim kushtetues plotësohet më tej nga dispozita të veçanta të shpërndara në Kushtetutë apo edhe në ligje të tjera, e në këtë aspekt

Presidenti sipas nenit 92, germa "gj", të Kushtetutës ka kompetencë caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve. Kjo kompetencë lidhur me datën e zgjedhjeve është e vetmja si e tillë e shprehur në rendin ligjor shqiptar, thënë kjo duke konsideruar edhe situatën rregullatore të Kodit Zgjedhor, i cili në asnjë dispozitë të tij nuk parashikon kompetenca të tjera, përveç sa është parashikuar në Kushtetutë. Aspektet e vetme që rregullohen nga nenet 64 e vijues të këtij kodi lidhen me afatet dhe përcaktimin e periudhës zgjedhore. Kolegji vëren se, në mungesë të një kompetence të shprehur në ligj, çdo veprim tjetër tej kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji, bie ndesh jo vetëm me një dispozitë urdhëruese sikurse është neni 94 i Kushtetutës ku parashikohet se "Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerrja në pajtim me të", por edhe me jurisprudencën e vetë Gjykatës Kushtetuese. ... Parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore....".

12. Kolegji, arsyetoi edhe se: "...referuar neneve 8, 9 dhe 10 të Kodit Zgjedhor, ... Kolegji çmon të bazuar qëndrimin e KQZ-së ku shprehet në vendim se: "dekretimi duhet bërë duke respektuar periudhën zgjedhore (neni 8)", dhe se dekretimi duhet bërë jo më vonë se 9 muaj ... (neni 9)". Presidenti i Republikës ka kompetencë të kufizuar në kohë, dhe tej kësaj kohe, ai nuk ka më asnjë kompetencë për të vepruar në këtë drejtim. Pra, as mund të ndryshojë dhe as mund të shfuqizojë datën e zgjedhjeve. Të dyja këto parashikime të Kodit Zgjedhor nuk janë respektuar në nxjerrjen e dekretit të dytë, për rrjedhojë, janë momente që e bëjnë dekretin e dytë të Presidentit të Republikës të jetë në shkelje të hapur dhe në mënyrë flagrante me dispozitat ligjore në kuptim të nenit 108, paragrafi 2, germa "a" të Kodit të Procedurave Administrative... Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji Zgjedhor çmon se Presidenti i Republikës, nëpërmjet anulimit të datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të 30 qershorit 2019, në mungesë të kompetencës ligjore dhe tej afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, ka marrë kompetencat e një organi tjetër, konkretisht ka marrë kompetencat e Kuvendit të Shqipërisë. Në kushtet kur është Kuvendi organi që ka parashikuar afatet dhe rregullat e përcaktimit të datës së zgjedhjeve përmes parashikimeve të Kodit Zgjedhor, çdo ndryshim i mundshëm i tyre, në mungesë të delegimit, duhet të bëhet vetëm nga ky organ, pra vetëm nga Kuvendi i Shqipërisë. Gjithashtu, Kolegji Zgjedhor çmon se anulimi i datës së zgjedhjeve në mungesë të kompetencës ligjore dhe në shkelje të afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor bën që në fakt, shtetasve shqiptarë me të drejtë vote t'u mohohet një e drejtë kushtetuese e parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur sipas nenit 45 të Kushtetutës. Ky fakt bie ndesh edhe me parashikimet e Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias e konkretisht me pikën 1, votimi universal, duke parashikuar se Votimi universal konsiston në të drejtën elektorale aktive (e drejta për të votuar) si dhe pasive (e drejta për t'u zgjedhur). ... me parimet bazë të trashëgimisë Elektorale Evropiane. ...Nëpërmjet anulimit të datës së zgjedhjeve bëhet edhe zgjatja e mandatit të organeve të qeverisjes vendore tej afatit ligjor, e një gjë e tillë është e papranueshme, pasi bie ndesh me nenin 1, pika 3 dhe nenin 2, pikat 1 e 2 të Kushtetutës...."

13. Dekreti nr. 11199, datë 10.06.2019 u bë shkak për disa situata kaosi dhe dhune si dhe shkaktoi pasiguri juridike në disa zona të vendit, kryesisht në ato bashki që drejtoheshin nga përfaqësues të opozitës jashtë parlamentare. Organizatorët e këtyre protestave pretendonin se zgjedhjet e 30 qershorit nuk mund të mbaheshin, përderisa ka dalë një dekret i Presidentit që i pati anuluar ato. Zyrat e komisioneve zonale të administrimit të zgjedhjeve në disa bashki, si Shkodër apo Tropojë u dogjën gjatë protestave të opozitës jashtëparlamentare me pjeëmarrjen e mbështetësve të saj. Këto episode ishin të izoluar në disa zona dhe organet e rendit mundën të menaxhonin me profesionalizëm dhe në përputhje me ligjin këto situata duke ruajtur rendin dhe qetësinë publike, ndërsa organet e administrimit zgjedhor bënë të mundur riorganizimin e zyrave vendore të djegura dhe ecurinë e procesit zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vijoi me administrimin e të gjithë procesit zgjedhor që u zhvillua normalisht në datën 30 Qershor, në të gjithë vendin, dhe nuk pati asnjë situatë dhune apo kaosi për ta nxjerrë procesin jashtë kontrollit. Zgjedhjet e 30 Qershorit u vëzhguan edhe nga organizmat e huaja e në veçanti nga OSBE/ODHIR. Aktualisht, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po nxjerr rezultatet e zgjedhjeve dhe po shpallen mandatat për kryetarët e Bashkive, ndërkohë që në ditët në vijim Kolegji Zgjedhor do të vendosë për ndarjen e mandateve të këshillave bashkiake.

14. Duke vlerësuar se me anulimin, në mënyrë krejt arbitrare dhe pa ligj, të datës së zgjedhjeve, Presidenti i Republikës ka kryer një shkelje të rëndë të Kushtetutës, një grup prej 55 deputetësh të Kuvendit, bazuar në nenin 90/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 112 të Rregullores së Kuvendit, që normon procedurën që ndiqet në një rast të tillë, kanë paraqitur në datën 17.06.2019 një kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Deputetët çmojnë se dekreti i Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve vendore është në kundërshtim të hapur dhe flagrant me parimet kushtetuese të një republike parlamentare, si edhe me funksionet që parashikon Kushtetuta për Presidentin e Republikës, i cili mbart jo vetëm pozicionin e Kryetarit të Shtetit por edhe atë të përfaqësuesit të unitetit të popullit shqiptar. Në arsyetimin e kërkesës së tyre, deputetët nënvizojnë se Presidenti i Republikës me aktin e tij dhe me pasojat e rënda që krijohen:

- ka cenuar rëndë parimin e ushtrimit të sovranitetit nga ana e popullit;
- ka shkelur Kushtetutën dhe ka marrë njëkohësisht tagra të sovranit dhe Kuvendit;
- është sjellë arbitrarisht me pushtetin si pushtet ekzekutiv i pakufizuar, përkundër natyrës së Republikës Parlamentare;
- ka shfuqizuar arbitrarisht datën e zgjedhjeve;
- ka cenuar parimin e periodicitetit të zgjedhjeve;
- ka zgjatur tej afateve kushtetuese e ligjore mandatin e organeve zgjedhore ekzistuese;
- ka cenuar parimin e ushtrimit të pushtetit në shtet nga një qeverisje e dalë nga zgjedhje të lira;
- ka cenuar parimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë;
- ka nxjerrë një akt në kundërshtim të hapur dhe flagrant me Kushtetutën dhe ligjet;
- ka cenuar parimin e të drejtës së qytetarëve si sovranë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

15. Ndërkohë që Kuvendi ka filluar kryerjen e të gjitha procedurave parlamentare që lidhen me fillimin e procedurës për shkarkimin e Presidentit të Republikës, në datën 27.06.2019, me një dekret të tretë, Dekreti nr. 11211, datë 27.06.2019, Presidenti i Republikës ka vendosur të caktojë datën 13 Tetor 2019 për zhvillimin e zgjedhjeve vendore, datë e cila deri më sot është pranuar

vetëm nga një parti politike, LSI.

16. Aktualisht, Kuvendi po vijon me procedurat për shqyrtimin e kërkesës së deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Sipas rregullores së Kuvendit, neni 112, kjo procedurë përmbledhet në tre faza, ku në fazën fillestare Komisioni për Çështjet ligjore shqyrton bazueshmërinë e kërkesës, përmbushjen e kriterëve formale procedurale dhe nëse i gjen në përputhje me kriteret ligjore, i propozon Kuvendit ngritjen e një Komisioni të Posaçëm Hetimor për verifikimin e përmbajtjes së pretendimeve (shkeljet e rënda që pretendohet se janë kryer). Komisioni hetimor kryen veprimtarinë e tij, sipas parashikimeve të Rregullores së Kuvendit dhe Ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe në përmbyllje të veprimtarisë së vet i propozon Kuvendit shkarkimin ose jo të Presidentit. Kuvendi në seancë plenare (faza e fundit) shqyrton dhe vendos me shumicë të cilësuar votash (2/3 e gjithë anëtarëve të Kuvendit) miratimin e propozimit për shkarkim. Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e Presidentit dërgohet në Gjykatën Kushtetuese nga Kryetari i Kuvendit, e cila shqyrton bazueshmërinë e këtij vendimi. Gjatë kohës që pritet shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti qëndron në detyrë. Si pasojë e zbatimit të reformës në drejtësi, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nuk është funksionale, pasi shumica e anëtarëve të saj, nuk kaluan me sukses procesin e vetting-ut¹. Procedurat për zëvendësimin e vendeve të Gjykatës Kushtetuese kanë nisur dhe janë drejt përfundimit dhe pritet që brenda vjeshtës së këtij viti këto vende vakante të fillojnë të plotësohen, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së saj.

17. Komisioni për Çështjet ligjore ka shqyrtuar bazueshmërinë e kërkesës së 55 deputetëve, përmbushjen e kriterëve formale procedurale dhe e ka gjetur kërkesën në përputhje me kriteret ligjore, duke i propozuar Kuvendit me raportin dhe vendimin datë 26.06.2019 ngritjen e një Komisioni të Posaçëm Hetimor. Kuvendi me vendimin nr. 84, datë 08.07.2019 ka vendosur ngritjen e komisionit hetimor me përbërje prej 9 anëtarësh, 5 deputetë nga radhët e mazhorancës dhe 4 deputetë nga radhët e opozitës. Komisioni hetimor është konstituar në datën 11.07.2019 dhe ka miratuar planin e hetimit dhe rregulloren e veprimtarisë së tij.

18. Në mbledhjen e datës 15.07.2019, Komisioni hetimor, duke mbajtur në konsideratë faktin se një kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës po shqyrtohet për herë të parë në Kuvendin e Shqipërisë, me qëllim vendosjen e këtij procesi mbi standarde të gjithëpranuara ndërkombëtarisht, mbi të cilat duhet të orientohen në vijimësi institucionet kushtetuese të shtetit

¹ Në vitin 2016, Kuvendi miratoi një sërë ndryshimesh kushtetuese që i hapën rrugën një reforme gjithëpërfshirëse dhe të gjithanshme të drejtësisë. Ndryshimet kushtetuese prekën një të tretën e Kushtetutës dhe ndryshojnë radikalisht sistemin shqiptar të drejtësisë. Ndryshimet kushtetuese, që u pasuan nga miratimi i një sërë ligjesh, konsistojnë në një ristrukturim të plotë të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë me qëllim rritjen e pavarësisë dhe efikasitetin e gjyqësorit dhe organit të akuzës, krijimin e mekanizmave llogaridhënës, de-politizimin e institucioneve të drejtësisë dhe instalimin e mekanizmave zhbllokues për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë sa i takon pasurisë së krijuar, integritetit moral dhe profesionalizmit ose sic njihet ndryshe, procesi i vetting-ut. Ky proces kryhet nga një autoritet i pavarur, nën monitorimin e një misioni ndërkombëtar dhe përputhshmëria e tij me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut është konfirmuar nga Komisioni i Venecias. Aktualisht rreth 800 gjyqtarë dhe prokurorë janë duke kaluar këtë proces, që ka nisur në shtator të vitit 2018.

shqiptar, ka vendosur t'i drejtohet me një kërkesë për opinion Komisionit të Venecias.

19. Në kuptim të sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë do të vlerësonte shumë opinionin e Komisionit të Venecias, si për pyetjet sa më poshtë, ashtu edhe për çdo çështje tjetër që lidhet me rastin në shqyrtim:

1. Cili është roli i Presidentit të republikës në regjimet parlamentare si Shqipëria, në raport me pushtetet e shtetit sa i takon proceseve zgjedhore?
2. Cilat janë detyrimet kushtetuese dhe konventore që i imponohen Presidentit të Republikës në regjimet parlamentare, siç është edhe Shqipëria, në ushtrimin e kompetencës për caktimin e datës së zgjedhjeve?
3. A ka kufizime në ushtrimin e kësaj kompetence që rrjedhin nga e drejta demokratike e zgjedhësve për ta ushtruar këtë të drejtë sipas marrëveshjes kushtetuese, me siguri dhe parashikueshmëri?
4. Kompetenca e Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve, është një e drejtë e tij për të vendosur ushtrimin e sovranitetit të popullit, apo një detyrim i tij për të garantuar cilësisht ushtrimin e sovranitetit popullor nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesve të tij, brenda kufizimeve që sovrani ka vendosur nëpërmjet Kushtetutës së miratuar prej tij?
5. Nëse Presidenti i Republikës, pasi e ka caktuar datën e zgjedhjeve dhe organet e administrimit të zgjedhjeve janë duke kryer veprimet sipas ligjit, e anulon dhe cakton një datë tjetër, a kemi cenim të parimeve të së drejtës për të zgjedhur dhe të sigurisë kushtetuese, në funksion të respektimit të shtetit të së drejtës ?
6. Në rastin e mësipërm, a kemi ndërhyrje të Presidentit të Republikës në procesin zgjedhor, duke cenuar të drejtën e subjekteve zgjedhore për të konkurruar në mënyrë të barabartë dhe të lire?
7. Nisur nga parimi se qeverisja duhet të dalë nga një sistem zgjedhjesh periodike, që mbahen çdo katër vjet, nxjerrja e Dekretit të Presidentit që anulon datën 30 Qershor 2019 si datë të mbajtjes së zgjedhjeve vendore dhe që zgjat qëndrimin në detyrë të përfaqësuesve në këshilla bashkiakë dhe kryetarëve të bashkive, tej mandatit katër vjeçar, a e respekton parimin e periodocitetit të zgjedhjeve?
8. Duke patur parasysh se ndryshimi i datës së zgjedhjes ndikon tek pritshmëritë ligjore për subjektet zgjedhore dhe zgjedhësit, a konsiderohet se cenohet siguria juridike në këto raste? A është i lidhur cenimi i sigurisë juridike me pasojat që vijnë apo mjafton shkelja e parashikimeve kushtetuese dhe cenimi konsiderohet i kryer?

I dashur Z. BUQUICCHIO,

Nisur nga ndjeshmëria dhe situata ku ndodhet vendi, do të vlerësonim shumë opinionin tuaj sa më shpejt që të jetë e mundur.

Duke ju siguruar për konsideratën më të lartë për Ju dhe Komisionin e Venecias, mbetemi të pritje të përgjigjes tuaj.

Ju lutem, gjeni bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues të kësaj kërkesë.

Juaji Sinqerisht,

GRAMOZ RUÇI

